



VENDIM

Nr. 159, Datë 06.10.2016

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETVEVE TË SHOQËRISË “EURON ENERGY” SH.P.K, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SH.A.

Ne mbeshtetje te neneve 16; 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 6; 7 dhe 8 te “Rregullores per procedurat e transferimit te asetëve nga te licensuarit” te miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s, Nr.119, date 21.07.2016; pikes 1.3 dhe 1.6 te “Licenses per Prodhimin e Energjise Elektrike” gjithashtu dhe nenit 15 të “Rregullores per Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, date 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave per shqyrtimin e kerkeses se shoqerise “EURON ENERGY”sh.p.k, per lenie peng asetesh ne favor te bankes “Societe Generale Albania”sha, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “EURON ENERGY” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit” si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat:** “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licensuarit, te leshuar jo me vone se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licensuar); “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licensuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licensuar); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që

*kërkohet të transferohen); “i” (deklarate me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehe gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me pale të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit);*

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me gërmën “j” të pikës 1 të nenit 7 (nese ka patur, listen e transferimeve te kryera me heret nga i njejti subjekt), do te njoftohet subjekti qe ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EURON ENERGY” sh.p.k, për lenie peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania”sh.a.
2. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**